



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Zhvillim Kurrikule

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane “
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së 9nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Në përfundim të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje: të gjejnë, të kuptojnë dhe të kritikojnë në mënyrë konstruktive kurrikulën shkollore, nëpërmjet analizës së ngjarjeve historike e sidomos atyre aktuale dhe dialogëve teorikë. të eksplorojnë proceset e shkrimit të kurrikulës dhe të ekzaminojnë në mënyrë kritike çështjet aktuale në kurrikulën shkollore shqiptare në raport me teoritë që ekzistojnë për hartimin e kurrikulës. Të analizojnë interesat personale, politike, profesionale dhe shoqërore të përfshira në zhvillimin e kurrikulës,

Objektivat specifike lëndore:

Në përfundim të studimit të lëndës studentët do të jenë të aftë:

1. Të zbatojnë konceptet themelore të kurrikulës në klasë
2. Të analizojnë karakteristikat kryesore të kurrikulës
3. Të evidentojnë problemet në zbatimin e kurrikulës
4. Të zbatojnë modelet kurrikulare të avancuara në mësim

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti është në gjendje të analizojë dhe vlerësojë në mënyrë kritike teoritë dhe modelet e hartimit të kurrikulës, si dhe të shqyrtojë ndikimin e faktorëve historikë, politikë dhe socialë në zhvillimin e saj.
2. Studenti zbaton në mënyrë të arsyetuar konceptet dhe modelet kurrikulare në praktikën mësimore, duke identifikuar problematikat në zbatim dhe duke propozuar ndërhyrje përmirësuese në përputhje me nevojat konkrete të kontekstit shkollor.